



Luljeta Minxhozi ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës për Ekonomi Politike. Zonja Minxhozi ka një eksperiencë akademike mbi 30 vjeçare gjatë së cilës ka qenë lektore për lëndët “Ekonomi Politike”, “Kapitalizmi”, “Histori e Doktrina e Ekonomike” për 11 vjet në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës.

Nga viti 1996 deri në vitin 2002 po në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, Prof. Minxhozi ka qenë lektore e lëndëve “Hyrje ne Mikroekonomi dhe Makroekonomi” dhe “Ekonomi Zhvillimi”. Gjatë kësaj kohe Prof. Minxhozi ka dhënë mësim edhe në institucione brenda dhe jashtë vendit si Instituti për Europën Qendrore-Lindore dhe Ballkanin me qendër në Bolonja, Itali si dhe në Universitetin e New York-ut në Tiranë. Prej vitit 2008 deri në 2018, Prof. Minxhozi ka qenë profesor me kohë të plotë pranë Universitetit European të Tiranës duke mbuluar edhe pozicionin e Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit.

Aktualisht, Prof. Minxhozi mban pozicionin e Zëvendës Guvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë. Prof. Minxhozi është gjithashtu anëtare e bordit shkencor dhe lektore e programit pas universitar “The International Faculty” mbeshtetur nga Centro per L’Europa Centro-Orientale e Balcanica (CECOB), Universiteti i Bolonjës dhe Polo Scientifico-Didattico, Forli, Itali.